



Ftesë për regjistrim për punëkërkuesit e riatdhesuar

Me qëllim të ofrimit të mbështetjes për personat e riatdhesuar në Kosovë, në realizimin e integritit socio-ekonomik, dhe si përpjekje e shtuar për të ndihmuar rimëkëmbjen ekonomike gjatë përballjes me pandeminë COVID-19:

Projekti Programet Aktive të Tregut të Punës (PATP2/UNDP) në kuadër të komponentës për mbështetje për riintegrim të qendrueshëm për persona të riatdhesuar, shpall të hapur thirrjen për regjistrim të personave të riatdhesuar të papunë me qëllim të identifikimit dhe klasifikimit të nevojave të tyre, në mënyrë që t'i mundësohet aplikimi në skema të aftësimit dhe punësimit.

Ftohen të gjithë të riatdhesuarit në **5 vitet e fundit**¹, të interesuar për programet në kuadër të masave aktive të tregut të punës në Kosovë, të regjistrohen në platformë duke klikuar **këtu**, apo në vegëzën <https://forms.gle/1bCYs1zwtqBXRnvY6>

Vini re: regjistrimi në platformë nuk është aplikim për skema, por është shprehje e interesimit për t'u profilizuar për më tutje përmes vlerësimit të nevojave dhe kategorizimit për të aplikuar në njërin nga skemat e aftësimit dhe punësimit: Trajnim në Punë, Subvencionim i pagës, Vetpunësim (Grante).

Afati për regjistrim: 26 Shtator 2021 ora 17:00

¹ Të drejtë regjistrimi kanë vetëm personat e riatdhesuar në Kosovë pas datës **01.09.2016**